




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

|  |                      |
|--|----------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA-KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO    |                      |
| KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE |                      |
| SKENDERAJ  |                      |
| Nr.  |                      |
| No.  | 02-052/01-0020953/26 |
| Data.  |                      |
| Data.  | 05.06.2026           |



**Komuna Skenderaj**  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

## Raporti i Dëgjimit Buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029

### KONSULTIMI PUBLIK

Konsultimi publik u hap më 25.05.2026 me dokumentin i cili u publikua në platforma të ndryshme si dhe duke njoftuar publikun për procesin e konsultimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029 dhe mundësinë e tyre për të dhënë komente.

Publikimi në webfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjete sociale:

Në faqen zyrtare: <https://skenderaj.rks-gov.net/news/njoftim-per-degjimin-buxhetor-publik-me-qytetare-per-kab-2027-2029/>

Publikimi në facebook: <https://www.facebook.com/share/p/198WxnhEX1/>

### KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË

Më datë, 03 qershor 2026, sipas kalendarit të publikuar është mbajtur takimi për KAB në sallën e Kuvendit Komunal, kati IV. Të pranishëm kanë qenë Kryetari i Komunës z.Sami Lushtaku, nënkryetari z.Fadil Nura, drejtori i drejtorisë për Buxhet e Financa Behxhet Maliqi si dhe drejtorët të drejtorive komunale.

Në dëgjimin publik morën pjesë përfaqësues të lagjeve dhe fshatrave, organizata të shoqërisë civile, gra, studentë, fermerë, sportistë dhe qytetarë të tjerë. Gjatë diskutimeve u ngritën çështje dhe u paraqitën propozime nga fusha të ndryshme si bujqësia, mbështetja për personat me aftësi të kufizuara, infrastruktura rrugore, ndriçimi publik dhe sektorë të tjerë me rëndësi për zhvillimin e komunës.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

<https://skenderaj.rks-gov.net/news/mbahet-degjim-publik-per-pergatitjen-e-kornizes-afatmesme-buxhetore-kab-2027-2029/> dhe në facebook: <https://www.facebook.com/share/p/1HUAXafogB/>

Konsultimi publik filloi sipas kalendarit të publikuar në vegëzën: <https://skenderaj.rks-gov.net/news/njoftim-per-degjimin-buxhetor-publik-me-qytetare-per-kab-2027-2029/> dhe në facebook <https://www.facebook.com/share/p/198WxnhEX1/>

Konsultimin e shpalli të hapur drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Behxhet Maliqi.

| Kërkesat / Sugjerimet / Komentet   | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mës pranimin te komenteve është i detyrueshëm)   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pranohet</li> <li>- Pranohet pjesërisht</li> <li>- Nuk pranohet</li> </ul> |
|--|---|---|
| <p><b>Sadri Gaxhiqi – Kryetar i fshatit Murgë:</b><br/>Kërkesë për 900m rrugë, në tërë fshatin, kanalizim i papërfunduar në dy lagje L.Gaxhiqi dhe L.Islamaj, ndriçimi i rrugës, mungesë e ujit edhe pse sistemi është. A janë të përfshira në projekt këto kërkesa?</p> | <p><b>Behxhet Maliqi:</b> Si komunë e kemi në projekt kapital kanalizimin, rrugët kryesore në Bashkësi Lokale në të gjitha fshatrat. Gjatë vitit 2027 do të bëjmë përpjekje maksimale që të mund të realizojmë çdo kërkesë të qytetarëve. Është e pamundur t'i mbërrijmë të gjitha për shkak të kufizimit të buxhetit dhe tërëhjekjes së mjeteve financiare nga përmbaruesi, sidomos në buxhetin e projekteve kapitale që është sfidë e madhe për Komunën tonë.</p> <p><b>Fadil Nura:</b> Pjesa me e madhe e rrugicave të lagjeve janë të kontraktuara, problemi mbetet te ekzekutimi, për shkak të përmbaruesit, i cili i ka marrë mbi 4milion euro nga projektet kapitale. Të ndriçimi, është i kontraktuar, është duke vazhduar.</p> | <p>- Pranohet</p>   |
| <p><b>Xhevrije Thaqi – Lagja II Skenderaj:</b><br/>Kemi problem me mungesë të ujit, sidomos gjatë ditës, shtëpitë në rrugën 28 shkurti dhe një rrugë tjetër. A mund ta di pse ende vazhdon ky problem, që 15 vite i njëjti problem për lagjën tonë?</p>                  | <p><b>2. Fadil Nura:</b> Problemi i menaxhimit të ujit nuk është kompetencë e Komunës, por përgjegjësi e kompanisë së ujësjellësit, pra qeveritare. Ne si komunë jemi të gatshëm që të ndihmojmë në zgjidhjen e problemit se bashku me Kompaninë e Ujësjellësit.</p>  | <p>Pranohet</p>   |

|  |  |                        |
|--|--|------------------------|
| <p><b>Arsim Haziraj – Përfaqësues i HANDIKOS në Skenderaj:</b> A ka mundësi të na përfshini në linjën buxhetore, kemi mungesë të buxhetit dhe financimit?<br/>Jemi duke punuar në baza vullnetare.</p> | <p><b>Fadil Nura:</b> Çështjen e përkrahjes tuaj mund ta përfshijmë edhe përmes subvencioneve, shpesh kemi thirrje për përkrahje të OJQ-ve, përmes ndonjë projekti të vogël, kurdo që ne i kemi thirrjet mund ta përfshijmë.</p>   | <p><b>Pranohet</b></p> |
| <p><b>Shyqeri Gaxhiqi – Fermer:</b> Çdo herë aplikojmë për mjete bujqësore por asnjëherë nuk perfitojmë, pyetja është pse po mungon përkrahja e Komunës?</p>   | <p><b>Fadil Nura:</b> Jemi munduar që t'i përkrahim të gjithë, shumë i kemi ndihmuar por kërkesa ka pasur shumë edhe mund t'kenë mbetur fermerë pa përfitur, por ne do të vazhdojmë me përkrahje.</p> <p><b>Behxhet Maliqi:</b> Pavarësisht vullnetit tonë, kërkesat gjithmonë janë më të mëdha se sa që i kemi mundësitë ne si Komunë, mirëpo ne do e kemi parasysh rastin tënd në projektet e ardhshme, sepse si Kuvend Komunal jemi të interesuar që t'i përkrahim fermerët e Komunës tonë.</p> | <p><b>Pranohet</b></p> |
| <p><b>Hana Zabeli:</b> E kam një kërkesë për me ndrru kryetarin e fshatit sepse ai para dy vitesh ka dalë me banim në Prishtinë dhe kemi mbetur disi anash?</p>  | <p><b>Behxhet Maliqi:</b> Në asamble ka kaluar komisioni për zgjedhjen e kryetareve të fshatrave, po besoj që shpejt ka me fillu procesi për zgjedhjen dhe edhe fshati Rezallë e Re ka me u ba me kryetar të ri.</p>   | <p><b>Pranohet</b></p> |

Komentet – Janë dhënë gjithsej 5 komente, prej të cilave 5 janë pjesë e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029.

| Tema                                     | Zyra              | Pjesëmarrës:                      | Vendi<br>Data   | Komentet   | 1.Njoftimi<br>2.Lajmi<br>3.Procesverbali   |
|--|-------------------|-----------------------------------|---|--|--|
| Dëgjim Buxhetor Publik për KAB 2027-2029 | Zyra për Informim | Total: 70<br>Gra: 28<br>Burra: 42 | <a href="https://skenderaj.rks.gov.net/news/njoftimi-per-degjimin-buxhetor-publik-me-qtetare-per-kab-2027-2029/">https://skenderaj.rks.gov.net/news/njoftimi-per-degjimin-buxhetor-publik-me-qtetare-per-kab-2027-2029/</a> | 5 kërkesa<br><br>Të gjitha kërkesat janë marrë për bazë. | 1. <a href="https://skenderaj.rks.gov.net/news/njoftim-per-degjimin-buxhetor-publik-me-qtetare-per-kab-2027-2029/">https://skenderaj.rks.gov.net/news/njoftim-per-degjimin-buxhetor-publik-me-qtetare-per-kab-2027-2029/</a><br><br>2. <a href="https://skenderaj.rks.gov.net/news/mbahet-degjim-publik-per-pergatitjen-e-kornizes-afatmesme-buxhetore-kab-2027-2029/">https://skenderaj.rks.gov.net/news/mbahet-degjim-publik-per-pergatitjen-e-kornizes-afatmesme-buxhetore-kab-2027-2029/</a><br><br>3. <a href="https://skenderaj.rks.gov.net/wp-content/uploads/2026/06/2237_260605141223_001.pdf">https://skenderaj.rks.gov.net/wp-content/uploads/2026/06/2237_260605141223_001.pdf</a> |

Ashtu siç është bërë edhe njoftimi publik për qytetarët, të njejtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t'i japin edhe në mënyrë elektronike tek emailt e zyrtarëve. Mirëpo asnjë koment nuk është pranuar në mënyrë elektronike për këtë Projekt-Propozim të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Njoftimi publik për konsultimin publik

Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik

Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik

**Besjana Thaçi**  
Zyrtare për Informim





Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

### Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin buxhetor publik me qytetarë për KAB 2027-2029

Dëgjimi buxhetor me përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatrave, OJQ-të, shoqatat e grave, shoqërinë civile, bizneset, fermerët, të rinjtë e studentët e Komunës së Skenderajt dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.

E mërkurë, 03 Qershor 2026, 13:30

Salla e Kuvendit komunal, KATI IV

| Emri dhe Mbiemri   | Lagjja/Përfaqësimi      | Nënshkrimi |
|--------------------|-------------------------|------------|
| Ali Aliu           | shenderaj L. 1          |            |
| ALBAN VOSVODA      | LAGJA 3                 |            |
| Bledion Meha       | Lagjia 3                |            |
| Zabimot Anushtemaj | Lagjia Anushtemi Gubrot |            |
| Linidom Fazliu     | Lagjia shtauhera Rumik  |            |
| Leotrim Brahim     | Baks                    |            |
| DIEDON RUSHITI     | SKENDERAJ L. 1          |            |
| Leonard Mehmetaj   | Kosterc                 |            |
| Valdrin Kadriu     | Litoc                   |            |
| Altin Veseli       | Skenderaj               |            |
| FATON OSMANI       | BAKS                    |            |
| LEONARD KARRIHANI  | BAKS                    |            |
| ALBAN MUSA         | PRICKAT I OSMAN         |            |
| Miranda Geci       | Lagjia 4                |            |
| Fazile Hajraj      | Rakinicë                |            |
| Higena Geci        | Lagjia II               |            |
| DOMART THAQI       | BURROJE                 |            |
| Hubib Hoxhaj       | Mami Recsen             |            |
| Xhavit Seferi      | Kosterc                 |            |
| Albulena Hoxha     | Albulena B.1            |            |
| Agnesa Hoxhaj      | Skenderajca             |            |
| Natyna Thaqi       | KPP - SHPRESA           |            |





